



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 09

Prishtinë, më 25.03.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Valdete Bajrami, Teuta Haxhiu, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Mungoi: Slavko Simiq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit, UNICEF.

Të ftuar: Prenk Gjetaj-kryetar i Komisionit qeveritar për persona të zhdukur dhe Nehat Fetoshi- përfaqësues i peticionit për zbardhjen e fatit të Ukshin Hotit.

Pjesëmarrës të tjerë: Edona Tolaj – YIHR, Selvete Gërxhaliu – GDNJD, Lejla Selimi – OSBE, Aziz Hamza, Gazmend Isa dhe Ramadan Dajqi- përfaqësues të peticionit për fatin e Ukshin Hotit, Florina Merovci-ZPRK, Ukë Gashi-ZRPK, Labinot LLapashtica –BIRN, Drilon Asllani-Tribuna Chanel, Alban Roci-Tribuna Chanel, Kushtrim Gara-ZKM-KQPZH, Xhemile Morina- ZKM-KQPZH dhe Arta Xhylani- praktikante, Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Ecuritë aktuale për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, duke përfshirë edhe Peticionin për zbardhjen e fatit të Mr. Ukshin Hotit. (Të ftuar për këtë pikë të rendit të ditës janë: Përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur dhe Përfaqësuesit e Peticionit.);
3. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Ecuritë aktuale për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, duke përfshirë edhe Peticionin për zbardhjen e fatit të Mr. Ukshin Hotit. (Të ftuar për këtë pikë të rendit të ditës janë: Përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur dhe Përfaqësuesit e Peticionit.)

Kryetarja- I falënderoj të pranishmit që i janë përgjigjur ftesës, për të marrë pjesë në mbledhje të Komisionit. Çështja e personave të zhdukur dhe e Profesorit Ukshin Hotit është mjaft e ndjeshme, edhe ne, si Komision, marrim obligimet tona për të bërë më shumë në të mirë të familjeve të personave të zhdukur dhe të vendit.

Prenk Gjetaj- Me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Persona të Pagjetur dhe Peticione kemi bashkëpunim të vazhdueshëm. Çështja e personave të zhdukur vazhdon të mbetet një breng e madhe edhe pas gjashtëmbëdhjetë vjetëve. Komisioni Qeveritar për personat e zhdukur është komision ndërmënishtor që prek të gjitha fushat që kanë të bëjnë me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Partnerët e involvuar në zbardhjen e fatit të persona të zhdukur janë Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, me qendër në Sarajevë. bashkëpunojmë ngushtë. Me shoqatat e familjarëve të personave të zhdukur bashkëpunojmë ngushtë. Kërkesa e shoqatave të personave të zhdukur janë mbajtja e seancave parlamentare dhe me fituar kushtin edhe për një debat në parlamentin evropian. Kemi raste kur familjarët shantazhohen dhe nuk bashkëpunojnë, nuk japin mostrat e gjakut për analiza, me shpresë se të afërmit e tyre janë ende gjallë, ka njohuri se ende ka varreza masive në Serbi.

Për fatin e zbardhjes së fatit të Ukshin Hotit, në asnjë takim me palën serbe nuk ka ndodhur që të mos e shtrojmë si temë dhe deri me tani nuk kemi përgjigjeje, ka dëshmitarë të gjallë, dihet se e kanë lëshuar të gjallë më 16 maj 1999, drejtori i burgut është i gjallë në Serbi dhe ai është adresa.

Nehat Fetoshi- Iniciativa e qytetarëve të Rahovecit për ta bërë këtë peticion ka qenë thjesht qytetare, pa ndikime partiake apo grupe. Ai ndihet i lumtur që ka hasur në

mbështetje kolosale të jashtëzakonshme të qytetarët e Rahoveci, për këtë peticion. Ne po të vazhdonim me mbledhje të nënshkrimeve do të arrinim t'i bënim edhe një milion, por pas arritjes së numrit mbi trembëdhjetëmijë nuk kemi vazhduar më tej. Ai në emër të nënshkruesve të peticionit e lexoi një deklaratë për Profesor Ukshin Hotin. Kërkojmë nga Kuvendi i Kosovës që të ndërmarrë të gjitha masat ndaj institucioneve të vendit që të angazhohen në fatin e zbardhjes së Profesorit, kërkojmë dhe shpresojmë se Komisioni do t'i japë drejtim të duhur çështjes së zgjidhjes së Fatit të Ukshin Hotit. Kërkojmë nga Komisioni që të dalë me një rekomandim për mbajtjen e një debati parlamentar për personat e pagjetur në Kosovë dhe për zbardhjen e fatit të Ukshin Hotit.

Kryetarja- E falënderoj zotin Fetoshi, për një mision mjaft human. Ajo tha se për t'u marrë më konkretisht me këtë peticion, kemi formua një grup punues dhe për këtë ja dha fjalën kryesuese së këtij grupi.

Mexhide Mjaku- Topalli- Ne, si grup punues, për shqyrtimin e këtij peticioni kemi takuar Komisionin qeveritar për persona të zhdukur dhe kemi pranuar edhe një raport. Dihet se Ukshin Hoti, është liruar një ditë para kohës, dihen aktorët se kush e kanë bërë lirim nga burgu i Dubravës. Ne sot ju kemi thirrur juve që t'ju dëgjojmë dhe nga ky takim të dalim me rekomandime më të kompletuara për ecuritë e mëturjes për zbardhjen e fatit të Ukshin Hotit, por edhe për fatin e të gjithë të zhdukurve në Luftën e fundit në Kosovë.

Ajo bëri pyetje se a eksitojnë pengesa administrative dhe teknike nga institucionet tona dhe sa ka bashkëpunim Komisioni qeveritar për personat e zhdukur me departamentin e mjekësisë ligjore.

Teuta Haxhiu- I falënderoi të pranishmit dhe tha se deri me tani nuk ka pasur diçka konkrete për fatin e Ukshin Hotit. Uroj që me rekomandimet e dala nga Kuvendi, të bëhet diçka pozitive, por tha se jam skeptike se do të ndodhë diçka edhe në të ardhmen, ajo pyeti Komisionin qeveritar për personat e zhdukur se a keni zyrtar për personat e zhdukur nëpër të gjitha komunat e Kosovës, dhe çka konkretisht kërkohet nga Komisioni që një person është i zhdukur? Unë kam informata se qytetarët serbë vinë dhe kërkojnë një vërtetim që qytetari i tyre është i zhdukur në Kosovë pa pasur argumente, a është e drejtë që me një certifikatë të lindjes të kërkohet që është person i pagjetur në Kosovë, ai mund të jetë edhe paramilitarë dhe të barazohet me të zhdukurit që kanë qenë duke mbrojtur trojet e veta në Kosovë. A jeni në dijeni ju, si Komision, se çështja e të zhdukurve është ngritur si temë në bisedimet në Bruksel në nivelin e ekspertëve, sepse kështu m' u ka përgjigjur Kryeministri në një pyetje që ia kam parashtruar. A ju ka njoftuar zyra e Kryeministrit për këtë. A mendoni se termi viktimë civile është adekuat për këtë kategori dhe çka keni bërë ju për këtë çështje, dhe a është bërë diçka prej nxjerrjes së rekomandimeve prej seancës kur është mbajtur një interpelancë për fatin e personave të zhdukur, a ka filluar me u realizuar diçka nga ajo që është premtuar?

Mytaher Haskuka- Tha se në peticion nuk ka kërkesa specifike drejtuar Kuvendit, mendoj të ketë një debat parlamentar për fatin e personave të zhdukur dhe në mënyrë specifike aty të debatohet edhe për fatin e Ukshin Hotit, dhe pas debatit me bërë një

kërkesë për Parlamentin Evropian, që edhe ata të angazhohen që fati i personave të zhdukur të hyjë në agjendën e bisedimeve në Bruksel.

Prenk Gjetaj- Ne, si Komision, udhëheqim procesin e fatit të personave të zhdukur, nuk ka pengesa institucionale, por ka mungesa profesionale. Ende varemi nga antropologët e EULEX-it, nuk kemi ekspert profesional vendor, kemi mungesë laborator, deri tani analizën e ADN-së e ka bërë Komisioni ndërkombëtarë, por ka paralajmëruar se do të përfundojë misionin në Ballkanin perëndimor në 2017, kemi 400 mbetje mortore dhe nuk ka përputhshmëri në ADN me personat e zhdukur, të kujt janë ato, 2000 persona janë varrosur pa ADN, kemi bashkëpunim me departamentin e Mjekësisë ligjore, E kemi të përcaktuar me ligj bashkëpunimin me nivelin lokal qendror, i kemi zyrtarët nëpër komuna, disa komuna janë më korrekte në bashkëpunim, por jo të gjithë zyrtarët janë në nivel. Lidhur me vërtetimet, në ligj nuk prejudikohet statusi pa marrë parasysh përkatësit racore, politike, fetare, statusin ushtarak e jo ushtarak, ai trajtohet si person i zhdukur dhe me ligji e gëzon të drejtën me marrë një dëshmi që vërtetë është person i zhdukur, kur do të bisedohet në Bruksel, edhe unë do të dëshiroja me ditë sikur ju, kryeministri ka thënë se do ta kemi si temë të bisedimeve, statusi viktimë civile, është çdo kush që ka qenë jashtë uniformës, nëse ka qenë aktiv në luftë dhe i uniformuar, ai e ruan statusin e dëshmorit, por i zhdukur, por viktimë civile të gjithë ata që janë kidnapuar si civilë, apo që janë vrarë si civilë, sa i përket zbatimit të rezolutave, nuk dijë që Komisioni qeveritar është obliguar diçka dhe nuk e ka zbatuar, e sa i përket të tjerëve nuk mund të jap përgjigjeje.

Etem Arifi- Tha që z. Gjetaj nuk e ka informacionin e duhur, përderisa thotë që 1 655 persona janë të zhdukur, ndërsa në anën tjetër lëshoni një vërtetim që nuk dihet se as kujt ia lëshoni, paskeni problem edhe me bazën e të dhënave. Ajo çka unë po kërkoj nga ju është një listë e të gjithë personave të zhdukur, apo të më tregoni saktësisht a ekziston real ky numër i të pagjeturve?

Prenk Gjetaj- Tha që vërtetimet lëshohen vetëm në raste të verifikuara, e numri i paraqitur tregon numrin për të gjithë të lajmëruarit si të pagjetur, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre, por të jenë qytetarë të Kosovës. Një shembull konkret është te Shoqata Shqiptare Atdhetare e Veteranëve në Kroaci kanë mbi 30 persona të zhdukur të evidentuar në kampet e tyre, e që në nuk i kemi të raportuar, me përjashtim të 5 rasteve. Prandaj edhe kanë kërkuar ndihmë nga institucionet e Kroacisë, duke mos anashkaluar edhe ndihmën e qytetarëve të Kosovës.

Salihe Mustafa- E falënderon kryetarin e Komisionit Qeveritar për persona të zhdukur që dha informata të shumta dhe nënshkruesit e peticionit të ishin të pranishëm. Ajo potencoi që të gjithë jemi përgjegjës për këtë brengë, andaj kem obligim bashkëpunimin si komision me Komisionin Qeveritar për të pagjetur, me këshillin koordinues që të shqyrtojnë peticionin dhe dërgimi i rekomandimit në kryesinë e kuvendit të Kosovës për debat parlamentar.

Mexhide Mjaku- Topalli- Sa janë ndërmarrë hapa për punët që politikë bërësit në nivel ndërkombëtar duhet të hartojnë plane dhe strategji. Njëkohësisht pajtohet me idenë e zotëri Mytaherit për një sërë rekomandimesh në fund.

Preng Gjetaj: Tha se kërkesa gojore me shkrim i është drejtuar zyrës së kryeministrit e filluar në vitin 2010 sipas raportit të Komisionit ndërkombëtar për personat e zhdukur, me qendër në Sarajevë, i cili kishte nxjerrë disa rekomandime për zgjidhjen e problemit, ku si rezultat i atij raporti është arritur deri te rishqyrtimi i morgut të Prishtinës. Sepse mbetjet mortore ishin aty nuk ishin në përputhshmëri, andaj rishqyrtimi ishte i nevojshëm e që kishte rezultuar me 200 mbetje mortore komplete dhe pjesë kockore e që përfaqësojnë 400 persona, mirëpo pa përputhshmëri. Pra, qëllimi i kësaj strategjie është se a t'i nxjerrin 2000 trupa nga varret apo të marrin gjak nga ata të cilët i kanë rivarrosur pa AND, ndonëse ndonjë rast mund të përputhet me mbetjet mortore, e që mendon gabimisht që e ka personin e vet aty. Andaj punët iu takojnë EULEX-it, Qeverisë, Komisionit dhe Komitetit Ndërkombëtar, e Zyra e Kryeministrit është në shqyrtim të kësaj kërkesë duke u informuar nga zyra jonë.

Kushtrim Gara: Tha se listat e personave të pagjetur janë të ndryshueshme për arsye të evidentimit të tyre kohë pas kohe, që largohen nga lista apo hynë në listë. Nga 6027 raste të personave të pagjetur, 300 raste prej tyre janë mbyllur, për shkaqe administrative, mirëpo në rastet kur është paraqitur ndonjë vërejtje për të dhënat në dosjet e të pagjeturve e të cilat në kundërshtim me paraqitjen e të dhënave nga personat gjegjësisht mund edhe të hiqen nga listat, pra si raste administrative. Marrja e një vërtetimi mund të realizohet me një certifikatë të lindjes, por që mund të marrë çdo qytetar i mundshëm, sepse janë disa procedura apo marrje e të dhënave familjare dhe të evidentueshme për personin e pagjetur. Ndërsa sa i përket dokumenteve të kuvendit të 11 prillit të 2011, ku në të njëjtën kohë janë mbajtur edhe interpelanca me ministren Tahiri dhe debate parlamentar, por nga kryesia kanë ardhur dy dokumente që njëra ka pasur të bëjë me atë që duhet të ndërpriten bisedimet me Serbinë deri në ndriçimin e personave të pagjetur, ndërsa në anën tjetër në dokumentin tjetër jepet përkrahje bisedimeve në Bruksel, pra po ka paqartësi. Si komision kemi biseduar edhe grupin parlamentar për rastin e z. Ukshin Hotit, në një debat disa orësh, e menjëherë pas diskutimit kemi përgatitur raportin 3 faqesh, për të përfunduar obligimin ndaj deputetëve dhe familjeve që kanë parashtruar këtë peticion.

Teuta Haxhiu- Pyeti se a ka qenë ndokush nga Komisioni Qeveritar për persona të pagjetur së bashku me 50 ekspertë të tjerë në bisedimet me Serbinë në Bruksel, apo a janë njoftuar për atë se çfarë është biseduar nëse është biseduar për të zhdukurit, pasi që sipas saj nga përgjigjja që i ka dhënë Kryeministri në seancë se ka pasur bisedime në nivel ekspertesh?

Kushtrim Gara: Theksoi se faktikisht ata e kanë njoftuar kryeministrin për bisedimet dhe çështjet e diskutuara. Dhe janë të obliguar që çështja e personave të pagjetur të diskutohet në bisedimet me Serbinë.

Salihe Mustafa- Pyeti për dy mjekët antropologë e që nuk janë mjaftueshëm të trajnuar dhe specializuar.

Prenk Gjetaj- Tha që mjekët e kanë mundësinë dhe të drejtën për trajnimet adekuate dhe brenda 2 viteve do të marrin thirrjen si ekspertë, dhe këto trajnime mundësohen nga Ministria e Drejtësisë dhe Shëndetësisë (mjekësia ligjore), ndërsa certifikohen nga institucionet ndërkombëtare.

Teuta Haxhiu- Pasi që bisedimet me Serbinë nuk po ndalen, duhet të kërkohet që çështja e personave të pagjetur të jete gjithnjë pjesë e bisedimeve, sepse është një shqetësim për të gjithë qytetarët, e mos të konsiderohet si pune politike, po të dëshmohet vullneti për rezultatin më të mirë për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.

Nehat Fetoshi- Vlerësoi që zbardhja e fatit të z. Ukshin Hotit dhe puna intensive do t' i relaksojë dhe do t' i qetësojë sado pak qytetarët e Rahovecit.

Lirije Kajtazi- Tha se do të bartim këtë për kryesinë e Kuvendit, e që në seancë të mos kemi vetëm diskutime, por diçka me konkrete, obligimi për gjetjen e fatit të z. Ukshin Hotit është e të gjithëve, diplomacia e tij dhe ndjeshmëria e tij në vendin tonë nxit edhe më shumë për punë efektive.

Të ndryshme

Mytaher Haskuka- Tha se për petitionin për shtrenjtimin e energjisë elektrike, që kryesia ka kërkuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrtimin e rekomandimeve që i ka dërguar Komisioni i ynë nëse kane implikime buxhetore, nuk jemi të njoftuar dhe nuk kemi asnjë material lidhur me këtë, se ne cilën fazë ka arritur, është mirë që për secilën lëndë të dihet se në cilën fazë të shqyrtimit është dhe ta kemi materialin dhe shkresat.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi